REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH
Njësia Org.
Org.Jedinica
Org Unit 01
Nr.Prot:
Broj Prot.
Prot.No 05-6769
Nr.i faqeve
Br.stranica
No.pages -2-
Data:
Datum:
Date: 24 / 09 / 2026
Prishtinë / a

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Zyra e Ministrit– Ured Ministra –Office of the Minister

Nr: 207/IX/2026
Datë: 22/09/2026

Ministri i Ministrisë i Shëndetësisë, në mbështetje të Nenit 145, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 11 dhe 12 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7, 01 Mars 2019), nenit 11, paragrafi 1.5 të Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, shkresën nr.prot. 05 – 6601, datë 18.09.2026, si dhe nenin 5 të Ligjit Nr.08/L-220 për çmimin e produkteve medicinale, nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. Miratohet Lista zyrtare e çmimeve të produkteve medicinale të Bartësve të autorizim marketingut dhe/ose përfaqësuesve të tyre **- Versioni 1.3.**

II. Afati i vlefshmërisë së çmimeve të produkteve medicinale është i përcaktuar në Listën zyrtare të çmimeve të produkteve medicinale e cila është pjesë e këtij vendimi.

III. Obligohen qarkulluesit me shumicë dhe pakicë që t'i përmbahen çmimeve të produkteve medicinale të përcaktuara në Listen e cila është pjesë e këtij Vendimi.

IV. Lista Zyrtare e çmimeve të produkteve medicinale është pjesë e këtij Vendimi dhe e njëjta publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetsisë dhe Agjencisë së Produkteve dhe Pajisjeve Medicinale.

V. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m i

Komisioni për Përcaktimin e Çmimeve të Produkteve Medicinale, me shkresën nr. 05-6601, datë 18.09.2026, ka kërkuar miratimin e Listës Zyrtare të Çmimeve të Produkteve Medicinale, e cila përmban çmimet e produkteve medicinale të deklaruara nga Bartësit e Autorizimit për Marketing ose përfaqësuesit e tyre.

Lista përkatëse përfshin gjashtë (6) produkte medicinale të deklaruara në qershor 2026, produktet për të cilat çmimet janë përcaktuar për herë të parë në korrik 2026, produktet e rideklaruara në shtator 2025, produktet e deklaruara për herë të parë në gusht 2026 si dhe njoftimit për deklaratat nën betim nga bartësit e autorizim marketingut dhe përfaqësuesit e tyre se pajtohen me çmimet e publikuara në listën

preliminare të datës 04.09.2026 dhe se nuk do të paraqesin ankesë, bazuar në dispozitat e nenit 5 të Ligjit Nr. 08/L-220 për Çmimin e Produkteve Medicinale, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dr.Arben Vitia

Ministër i Shëndetësisë

Vendim i dërgohet:

- *Zëvendësministrave të MSH-së;*
- *Sekretarit i Përgjithshëm;*
- *UD. Kryeshefit të AKPPM-së;,*
- *Z.Edon Muçaj, Kryesues i Komisionit;*
- *Komisionit të ankesave;*
- *Departamentit ligjor;*
- *Arkivit të MSh-së.*